



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 2068/15 Prot.

Patos, më 06/08/2025

PROCESVERBALI I TAKIMIT 05 GUSHT 2025

Vendi: Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Patos

Ora e fillimit: 09:00

Ora e mbarimit: 10:00

Dëgjese publike me temë: “Plani i Barazisë Gjinore 2026-2028”.

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe ligji nr. 9970 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 si dhe kërkesës nr. 1966 prot., datë 26.06.2025 të Drejtorisë së Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit.

Pjesëmarrës: Zv/ Kryetare e bashkisë znj. Ina Sauli, Anëtarë të Këshillit Bashkiak dhe përfaqësues të bashkisë Patos, , *rreth 21 pjesëmarrës (banorë, përfaqësues të shoqatave dhe shoqërisë civile, kryetarë të fshatrave etj)*

Takimin hapet nga zv/ Kryetare e bashkisë Patos znj. Ina Sauli

Zv/ Kryetare e bashkisë Patos, znj. Ina Sauli- përshëndetje! Ju falenderoj që jeni bërë pjesë kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe kërkesës me nr. 1966 prot., datë 26.06.2025 të Drejtorisë së Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit për zhvillimin e dëgjësës publike lidhur me Planin e Barazisë Gjinore 2026-2028, sot jemi mbledhur për të marr komentet dhe rekomandimet lidhur me draft planin e Barazisë Gjinore 2026-2028 të hartuar për bashkinë Patos.

Dua të thekoj që njoftimi lidhur me këtë dëgjese publike është bërë për periudhën 2025-2027, por në bashkëpunim me grupin e punës është vlerësuar që perioda e këtij dokumenti të jetë 2026-2028. Gjithashtu kërkojmë që ky ndryshim të bëhet me dije dhe të reflektohet edhe procedurat në vazhdim. Ju ftoj të gjithëve të ndiqni prezantimin e materialit dhe jemi të hapur për të marr komentet dhe rekomandimet tuaja.



**Zv/ Kryetare
znj. Ina Sauli**

**Dëgjese publike me temë:
“Plani i Barazisë Gjinore 2026-2028”
Gusht 2025**

Drejtore e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, znj. Elda Goxhaj-përshëndetje!
Ju falenderoj që jeni bërë pjesë të kësaj dëgjese publike.

Hartimi i Planit të Barazisë Gjinore përfaqëson një hap të rëndësishëm në përpjekjet për të integruar perspektivën gjinore në të gjitha politikat dhe shërbimet publike të ofruara nga bashkia. Përgatitja e Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2028 është zhvilluar në bazë të një metodologjie të kombinuar, që ndërthur analizën e thelluar të kontekstit lokal me orientimin nga kuadri ligjor dhe dokumentet strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare. Procesi ka qenë gjithëpërfshirës, i bazuar në të dhëna statistikore gjinore, në vlerësime institucionale dhe në praktikat më të mira të planifikimit vendor të barazisë gjinore. Dokumentet që kanë orientuar konceptimin e objektivave, rolin e qeverisjes vendore dhe përgjegjësitë institucionale në zbatimin e parimeve të barazisë gjinore, ligji nr. 9970 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030. Gjithashtu edhe dokumente mbështetëse si:

Karta Evropiane për Barazinë Gjinore në Jetën Vendore, Agjenda 2030 e Kombeve të Bashkuara - Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm (OZHQ) 5, 10 dhe 16). Në një periudhë trevjeçare, Bashkia synon të ndërtojë një realitet të prekshëm të barazisë gjinore, ku çdo vajzë dhe çdo djalë, çdo grua dhe çdo burrë, kanë mundësi të barabarta për të marrë pjesë dhe për të përfituar nga zhvillimi lokal. Përmes zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2028, do të konsolidohen strukturat institucionale, do të përmirësohet aksesueshmëria dhe cilësia e shërbimeve publike, do të zgjerohet pjesëmarrja e grave dhe

vajzave në vendimmarrje, dhe do të ndërtohen komunitete më të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj nevojave të ndryshme gjinore në çdo cep të territorit bashkiak. Qëllimet kryesore të këtij dokumenti janë: Qëllimi Strategjik 1, Forcimi i qeverisjes vendore përmes institucionalizimit të barazisë gjinore si parim themelor në çdo proces vendimmarrjeje, planifikimi dhe raportimi publik. Ky qëllim synon të konsolidojë qeverisjen vendore duke e trajtuar barazinë gjinore jo vetëm si një angazhim politik apo normativ, por si një komponent funksional dhe të domosdoshëm të mënyrës se si organizohen, menaxhohen dhe zhvillohet Bashkia. Ky qëllim fokusohet në ndërtimin e një kulture institucionale që njeh, promovon dhe mbron të drejtat dhe nevojat e grave dhe burrave në mënyrë të barabartë, duke garantuar përfaqësim të drejtë në strukturat e vendimmarrjes, përfshirje të balancuar në hartimin e politikave dhe qasje të njëjtë në shërbimet publike. Duhet që parimi i barazisë gjinore të integrohet sistematikisht në të gjitha dokumentet strategjike të bashkisë, në politikat dhe buxhetet vendore, në analizat dhe vlerësimet që zhvillohen nga institucionet publike, si dhe në mënyrën se si komunikohet dhe bashkëpunohet me qytetarët. Qëllimi strategjik 2, Zhvillimi dhe ofrimi i shërbimeve publike gjithëpërfshirëse, të cilësisë së lartë dhe të ndjeshme ndaj gjinisë, që adresojnë nevojat konkrete të grave dhe burrave në të gjitha zonat e territorit të Bashkisë.

Ky qëllim ka në qendër përmirësimin e ndjeshëm të cilësisë së jetës së qytetarëve përmes aksesit të barabartë në shërbime publike të përshtatura me realitetin gjinor dhe social të komunitetit. Ai synon që të gjitha shërbimet – si ato në arsim, shëndetësi, përkujdesje sociale, infrastrukturë, siguri publike, transport, dhe mbështetje për punësim – të projektohen dhe të zbatohen mbi baza që njohin dhe adresojnë në mënyrë të drejtë dhe efektive dallimet gjinore, ekonomike dhe territoriale mes qytetarëve. Qëllimi thekson rëndësinë e ofrimit të shërbimeve që janë të aksesueshme, të përballueshme dhe të përshtatshme për gratë, burrat, vajzat dhe djemtë – përfshirë personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, minoritetet dhe grupet në situata të cënueshme. Parimi i gjithëpërfshirjes kërkon që askush të mos mbetet pas në qasjen ndaj shërbimeve, ndërsa ndjeshmëria gjinore kërkon që çdo ndërhyrje të marrë parasysh rolet, përgjegjësitë dhe barrierat me të cilat përballen burrat dhe gratë në mënyrë të ndryshme në shoqëri. Thekson rëndësinë e ndërtimit të kapaciteteve institucionale dhe profesionale për të analizuar dhe përdorur të dhënat të ndara sipas gjinisë dhe grupmoshës në planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve, si dhe vendosjen e mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit të impaktit të tyre mbi barazinë gjinore dhe kohezionin social.

2.1. Garantimi i aksesit të barabartë dhe të balancuar territorialisht në shërbime publike të ndjeshme ndaj gjinisë, përmes strukturave vendore dhe mbështetjes ekonomike.

2.2. Rritja e efektivitetit të qasjes shumë-sektoriale për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të dhunës me bazë gjinore.

2.3. Transformimi i lagjeve në hapësira të sigurt dhe të aksesueshme për të gjitha grupet gjinore, përmes planifikimit urban të ndjeshëm.

2.4. Promovimi i përfshirjes së barabartë gjinore në jetën kulturore dhe sportive, përmes infrastrukturës, përmbajtjes dhe pjesëmarrjes së barabartë.

Zbatimi i Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2028 do të shoqërohet nga një sistem i dedikuar monitorimi dhe raportimi, i cili siguron ndjekjen në kohë reale të progresit, evidentimin e sfidave dhe përmirësimin e vazhdueshëm të veprimeve të ndërmarra.

Ky sistem do të bazohet në një qasje të kombinuar: institucionale, participuese dhe të bazuar në të dhëna.

Monitorimi i këtij plani do të jetë i strukturuar, me përgjegjësi të qarta për çdo njësi zbatuese; i bazuar në tregues të matshëm, të përcaktuar për çdo aktivitet; i hapur ndaj pjesëmarrjes së komunitetit dhe aktorëve jo publikë, për të garantuar transparencën dhe përfshirjen.

Jeni të lutur për të sjell në vëmendje pyetje dhe komentet tuaja lidhur me këtë plan.

Kryetar i Fshatit të Ri, Z. Bexhet Rredhi- Çfarë përqindje ka barazia gjinore aktualisht?



**Drejtore
znj. Elda Goxhaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Plani i Barazisë Gjinore 2026-2028”
Gusht 2025**

Përgjegjës i Emergjencave Civile, z. Arben Shpërdheja– përshëndetje të gjithëve!



**Përgjegjës i Emergjencave Civile
z. Arben Shpërdheja
Dëgjese publike me temë:
“Plani i Barazisë Gjinore 2026-2028”
Gusht 2025**

Në nivel strukture nuk ka barazi gjinore mendoj unë. Duke filluar që në ndërtimin e Planit sa është raporti i barazisë gjinore në grupin e punës?

Drejtores e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, znj. Elda Goxhaj– Ne jemi përpjekur të hartojmë një plan që përfshin disa aktivitete gjithëpërfshirëse. Ne jemi përpjekur ta shtrim në të gjithë objektivat e planit. Ne përpiqemi ti japim mundësi edhe vajzave dhe djemve. Lidhur me grupin e punës ka qenë 100% gra dhe vajza sepse e tillë është dhe drejtorja dhe punën që zhvillon.



**Drejtores
znj. Elda Goxhaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Plani i Barazisë Gjinore 2026-2028”
Gusht 2025**

Anëtare e Këshillit Bashkiak, znj. Vjollca Kasaj – Përsëritet! Do të doja të njihesha më shumë me aktivitetet e planit dhe të na i përshkruanit.



**Anëtare e Këshillit Bashkiak
znj. Vjollca Kasaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Plani i Barazisë Gjinore 2026-
2028”
Gusht 2025**

Drejtores e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, znj. Elda Goxhaj– Në qëllimin e parë që kishte të bënte me forcimin e qeverisjes vendore nëpërmjet barazisë gjinore aktivitetet janë: publikimi i planit në faqen e bashkisë, hartimi i tabelave dhe treguesve për monitorim, kalendar lokal i çdo organizimi aktiviteti për të drejtat e grave dhe dhunës në familje dhe jo vetëm, sistemi i integruar dixhital për mbledhjen dhe analizën e të dhënave,

trajnime për anëtarët e komisionit për barazinë gjinore në nivel bashkie mbi buxhetimin gjinor. Gjithashtu përfshihet draftimi dhe miratimi i një politike lokale kundër ngacmimit seksual dhe diskriminimit. Ky plan përfshin edhe takime informuese me administratorët shoqëror për rëndësinë e pjesëmarrjes në dëgjesa. Organizimi i një fushate sensibilizuese mbi rolet gjinore në lagjet urbane dhe rurale. Fushata komunikimi me mediat lokale dhe shkollat.



**Drejtore
znj. Elda Goxhaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Plani i Barazisë Gjinore 2026-2028”
Gusht 2025**

Anëtare e Këshillit Bashkiak, znj. Vjollca Kasaj – Si janë parashikuar të realizohen këto pika konkretisht nëpërmjet aktiviteteve?



**Anëtare e Këshillit Bashkiak
znj. Vjollca Kasaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Plani i Barazisë Gjinore 2026-2028”
Gusht 2025**

Drejtore znj. Elda Goxhaj- përveç këtij plani bashkitë janë të detyruara të zbatojnë edhe Strategjinë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe ne jemi munduar që këto pika tu përshatetn të dyjave. Do të hartohet një kalendar vjetor dhe do lidhet me vitin akademik të shollave dhe në bashkëpunim me ZVA duhet të miratojmë një plan së bashku që do të zbatohet. Ky plan do të jetë i integruar. Ne synojmë të ngrem njësinë e referimit sepse frejtorja jonë nuk e ka të ngritur njësinë e referimit të rasteve, por jemi në bisedime për ta përfshirë në strukturën e 2026. Kemi pasur nisma të ndryshme dhe duam që ti zhvillojmë sërish. Si qëllime të parashikuara janë edhe krijimi i një qendre, organizim i konsultimeve periodike me

trajnime për anëtarët e komisionit për barazinë gjinore në nivel bashkie mbi buxhetimin gjinor. Gjithashtu përfshihet draftimi dhe miratimi i një politike lokale kundër ngacmimit seksual dhe diskriminimit. Ky plan përfshin edhe takime informuese me administratorët shoqëror për rëndësinë e pjesëmarrjes në dëgjesa. Organizimi i një fushate sensibilizuese mbi rolet gjinore në lagjet urbane dhe rurale. Fushata komunikimi me mediat lokale dhe shkollat.



**Drejtore
znj. Elda Goxhaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Plani i Barazisë Gjinore 2026-2028”
Gusht 2025**

Anëtare e Këshillit Bashkiak, znj. Vjollca Kasaj – Si janë parashikuar të realizohen këto pika konkretisht nëpërmjet aktiviteteve?



**Anëtare e Këshillit Bashkiak
znj. Vjollca Kasaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Plani i Barazisë Gjinore 2026-2028”
Gusht 2025**

Drejtore znj. Elda Goxhaj- përveç këtij plani bashkitë janë të detyruara të zbatojnë edhe Strategjinë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe ne jemi munduar që këto pika tu përshatetn të dyjave. Do të hartohet një kalendar vjetor dhe do lidhet me vitin akademik të shollave dhe në bashkëpunim me ZVA duhet të miratojmë një plan së bashku që do të zbatohet. Ky plan do të jetë i integruar. Ne synojmë të ngrem njësinë e referimit sepse frejtorja jonë nuk e ka të ngritur njësinë e referimit të rasteve, por jemi në bisedime për ta përfshirë në strukturën e 2026. Kemi pasur nisma të ndryshme dhe duam që ti zhvillojmë sërish. Si qëllime të parashikuara janë edhe krijimi i një qendre, organizim i konsultimeve periodike me

organizata të ndryshme, krijimi i strukturave të njësive të vetqeverisjes vendore, shërbimi i arsimit parashkollor çerdhe, kopshte, ndërgjegjësimi i të rinjve me balancimin gjinor të rolit të prindit, krijimi i një programi vjetor të granteve të vogla për nxitjen e nismave të grave në vëmendje në zonat rurale. Gjithashtu shtimi i një programi trajnimit për të rinjtë në sektorin e turizmit, krijimi i qendrave komunitare në njësitet administrative, ofrimi i shërbimit në bancesë, ofrim i këshillimit të karrierës, hartimi i një protokolli gjinor në raste pandemie, fatkeqësi natyrore ose kriza civile dhe konsultime ligjore falas për gratë dhe vajzat sidomos. Në zbatim përfshihet edhe përfshirja e barabartë e grave dhe burrave në aktivitete artistike dhe kulturore.



Drejtoreshë
znj. Elda Goxhaj

Dëgjuesë publike me temë:
“Plani i Barazisë Gjinore 2026-2028”
Gusht 2025

Zv/ Kryetare e bashkisë, znj. Ina Sauli- ju falenderoj të gjithëve për pjesëmarrjen tuaj. E deklarojmë të mbyllur këtë dëgjuesë publike dhe uroj të takohemi në dëgjuesë të tjera.



Zv/ Kryetare e bashkisë
znj. Ina Sauli

Dëgjuesë publike me temë:
“Plani i Barazisë Gjinore 2026-2028”
Gusht 2025

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba